VENDIM
Nr. 658, datë 7.8.2013

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PERSONELIT DHE KAPACITETEVE TË NJËSISË SË SHËRBIMIT NË QENDRAT SPITALORE UNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësia bazë e fakultetit në qendrën spitalore universitare përbëhet nga "shërbime", të cilat janë njësi diagnostikuese dhe mjekuese themelore dhe formohen në bazë specialiteti.
2. Shërbimet në qendrat spitalore universitare ndahen në shërbime me shtretër dhe shërbime pa shtretër.
3. Shërbimi me shtretër në qendrat spitalore universitare ka jo më pak se 30 (tridhjetë) shtretër.
4. Shërbimi duhet të ketë shfrytëzim shtrati mbi 85%.
5. Shërbimi duhet të ketë në përbërje të tij të paktën dy anëtarë efektivë si personel pedagogjik me tituj shkencorë.
6. Numri i personelit mjekësor, që shërben në shërbimet e qendrës spitalore universitare, bazuar në numrin e shtretërve, miratohet me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.
7. Vendimi nr. 771, datë 7.11.2012 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kritereve për përcaktimin e numrit të personelit dhe kapaciteteve të njësisë së shërbimit në qendrat spitalore universitare", shfuqizohet.
8. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha